LIGJ
Nr.10 124, datë 11.5.2009

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË KREDISË SË EKSPORTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE UNICREDIT BANK AUSTRIA, AG PËR FINANCIMIN PËR PËRMIRËSIMIN E PAJISJEVE MJEKËSORE PËR SPITALIN UNIVERSITAR "SHEFQET NDROQI""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 84 pika 4 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e kredisë së eksportit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Unicredit Bank Austria, AG për financimin për përmirësimin e pajisjeve mjekësore për spitalin universitar "Shefqet Ndroqi"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.6165, datë 13.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

Kredi e Butë Nr. 229.611

Për shumën prej 7,488,000 EURO

Datë …… Maj 2009

arritur ndërmjet

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë duke vepruar në emër të Republikës së Shqipërisë

dhe përfaqësuar nga Ministria e Financave
(si "Huamarrësi")
dhe
UniCredit Bank Austria AG
(si "Huadhënësi")
lidhur me
Financimin e Përmirësimit të Pajisjeve Mjekësore për Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi"

Marrëveshja aktuale e kredisë për eksport për një kredi të butë Nr. 229.611 për një shumë prej 7,488,000 EURO ("Marrëveshja") datë ..... Maj 2009 është arritur ndërmjet HUAMARRESIT specifikuar në Shtojcën 1 ("Huamarrësi"), dhe HUADHENESIT ("Huadhënësi") specifikuar në Shtojcën 1.

1. PERCAKTIME

Në Marrëveshjen aktuale dhe Shtojcat e saj shprehjet e mëposhtme mbartin kuptime si më poshtë:

"Data e Pranimit"nënkupton datën në të cilën Marrëveshja është nënshkruar nga të dy palët dhe është ratifikuar nga ana e Parlamentit të Republikës së Shqipërisë.

"Shtojcë"nënkupton një shtojcë të Marrëveshjes aktuale kushtet e së cilës gjykohen të përfshihen në marrëveshjen aktuale dhe të bëhen pjesë e saj.

"Periudha
e Disponueshmërisë" nënkupton periudhën e përcaktuar në Shtojcën 3 gjatë së cilës fondet mund të tërhiqen ndaj shumës se Kredisë.

"Shuma të
Huamarrjes"nënkupton shumën e tërhequr nga ana e Huamarrësit kundrejt shumës së Kredisë.

"Ditë Pune"nënkupton një ditë në të cilën bankat janë të hapura për të kryer aktivitete biznesi dhe tregtare dhe depozitime në shkëmbime të huaja/valutë nëpërmjet bankave në Vjenë dhe Tiranë.

"Data e Përfundimit"nënkupton datën e përcaktuar në Paragrafin 7 të marrëveshjes aktuale.

"Ofrimi i Kredisë" nënkupton shumën e specifikuar në Shtojcën 3 prej së cilës Huamarrësi mund të realizoj tërheqje të shumave të huamarrjes gjatë Periudhës së Disponueshmërisë.

"EUR" ose "€" monedhën e vetme te vendeve anëtare të Bashkimit Evropian të cilët kanë pranuar Euron si monedhën e tyre në përputhje me legjislacionin e Komunitetit Evropian për sa i përket Bashkimit Ekonomik dhe Monetar Evropian.

"EURIBOR" nënkupton normën e përqindjes vjetore të barabartë me vlerën e momentit mbi bazën e konventës 365/360 të normës mesatare të depozitave EURIBOR të rënë dakord me EURIBOR FBE (faqe 248) për një periudhë të barabartë me periudhën për të cilën interesi duhet të përcaktohet nga ana e Huadhënësit (Pjesa 3.3) në ose rreth orës 11:00 të Brukselit në Ditën e dytë të Punës para fillimit të Periudhës së Interesit përkatës. Në këtë kontekst, "FBE" nënkupton "Federation Bancaire Europeenne/Federatën Bankare Evropiane".

"Llogaria e Kredisë" nënkupton llogarinë bankare të hapur në emër të Huamarrësit në përputhje me dispozitat e Paragrafit 2.3.

"Datat e
Shlyerjes së Interesit" nënkuptojnë 31 Marsin, 30 Qershorin, 30 Shtatorin dhe 31 Dhjetorin e çdo viti me kusht që, nëse ditë të tilla nuk përkojnë me Ditë Pune, referencat e ditëve të tilla i transferohen menjëherë Ditës pasardhëse të Punës.

“Periudha e Interesit” nënkupton një periudhë

i) që fillon në datën e Huamarrjes ose në datën e fundit të Periudhës së mëparshme të Interesit, dhe

ii) që përfundon në 31 Mars, 30 Qershor, 30 Shtator apo 31 Dhjetor të çdo viti.

“Garanci Pagese” nënkupton çdo hipotekim, detyrim, garanci pagese, pengesë, ruajtje e së drejtës apo të interesave të tjera të sigurisë të çfarëdolloj dhe që rrjedhin nga çfarëdolloj arsye.

“Huaja”nënkupton shumën totale të principalit të shumave të Huamarrjes të parashikuara sipas Sigurimit/Ofrimit të Kredisë që për momentin mbetet e papaguar.

“OeKB”nënkupton Oesterreichische Kontrollbank Aktiengesellschaft, Am Hof 4, A-1011 Vienna, Austri, që vepron si Agjencia e Kredisë për jashtë vendit për dhe në emër të Republikës së Austrisë.

“Garancia e OeKB” nënkupton një garantues të autorizuar nga OeKB si agjent/person referues i Republikës së Austrisë.

“Procedura e Shlyerjes”nënkupton procedurën për shlyerjen e Huamarrjeve të specifikuara në Shtojcën 4.

“Projekti” nënkupton Projektin e specifikuar në Shtojcën 2.

”Blerësi i Projektit”nënkupton blerësin e projektit specifikuar në Shtojcën 2.

”Eksportuesi i Projektit”nënkupton eksportuesin Austriak të përcaktuar në Shtojcën 2.

”Data e Përkohshme e Pranimit”nënkupton datën në të cilën Huadhënësit i është dorëzuar nga ana e Eksportuesit të Projektit kopja e COHO (të përcaktuar në Marrëveshjen e Blerjes);

”Marrëveshja e Blerjes”nënkupton marrëveshjen lidhur me Projektin të realizuar ndërmjet Eksportuesit të Projektit dhe Blerësit të Projektit dhe të përcaktuar në Shtojcën 2.

”Paragraf/Pjesë”nënkupton një paragraf të Marrëveshjes aktuale.

2. OFRIMI I KREDISË

2.1 Hyrje

Qëllimi i Marrëveshjes aktuale mbetet përcaktimi i kushteve dhe afateve mbi të cilat Huadhënësi do të financoj 100% të vlerës totale të kontratës (por deri në shumën maksimale të specifikuar si ”Kredia e Akorduar” në Shtojcën 3 të saj/Marrëveshjes) për t’ju paguar Eksportuesit të Projektit nga ana e Blerësit të Projektit në bazë të Marrëveshjes së Blerjes.

2.2 Ofrimi i Kredisë

Huadhënësi nëpërmjet marrëveshjes aktuale bie dakord të vërë në dispozicion të Huamarrësit Ofrimin e Kredisë gjatë Periudhës së Disponueshmërisë sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në Marrëveshjen aktuale me kusht që shuma e Huamarrjes të mund të realizohet nga ana e Huamarrësit në bazë të Ofrimit të Kredisë në përputhje me Procedurën e Shlyerjes të specifikuar në Shtojcën 4 dhe të realizueshme kundrejt shlyerjes së vlerës që i përket Eksportuesit të Projektit në bazë të Marrëveshjes së Blerjes.

Kredia e realizuar në këtë mënyrë ofrohet në bazë të dhe në vijim të dispozitave të rregullave dhe rregulloreve për kreditë për jashtë vendit të shpallura nga Republika e Austrisë. Huamarrësi në këtë mënyrë vëren se financimi mbështetet nga fondet e ndihmës publike me një element granti prej 35,23 % (tridhjetë e pesë pikë njëzet e tre për qind).

Huadhënësi mund të refuzoj lëvrimin e një shume Huamarrje nëse shuma e Huamarrjes dhe interesi mbi të në fjalë nuk do të mbuloheshin nga ana e dorëzanësit/garantuesit të autorizuar nga OeKB për dhe në emër të Republikës së Shqipërisë në përputhje me Aktin/Ligjin e Promovimit të Eksportit, të përmirësuar, dhe/ose në rastet kur marrëveshja e rifinancimit me OeKB për Ofrimin e Kredisë pushon së qeni në fuqi.

2.3 Llogaria ndihmëse

Huadhënësi hap një llogari ndihmëse në Euro në emër të Huamarrësit të përcaktuar si ”Llogaria Ndihmëse”. Çdo shumë Huamarrje e realizuar në bazë të marrëveshjes aktuale i debitohet Llogarisë Ndihmëse sipas vlerës dhe datës së shlyerjes së shumës në fjalë. Shlyerjet dhe parashlyerjet zbatohen kundrejt Llogarisë Ndihmëse në përputhje me rrethanat.

2.4 Pavarësia e Marrëveshjes dhe marrëveshja e blerjes

Marrëveshja aktuale dhe Marrëveshja e Blerjes përbëjnë marrëveshje të veçanta dhe të pavarura. Mosrealizimi nga ana e Eksportuesit të Projektit për të plotësuar detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Blerjes nuk ndikon mbi detyrimet e Huamarrësit kundrejt Huadhënësit, as që nuk mund të jetë përgjegjës Huadhënësi për mosrealizimet e Eksportuesit të Projektit dhe/ose çdo pale tjetër kundrejt Marrëveshjes së

Blerjes.

3. INTERESI

3.1 Interesi mbi llogarinë ndihmëse

Huamarrësi do të shlyej interesin në Datat e Shlyerjes së tij sipas normës fikse të specifikuar në Shtojcën 3, përllogaritur mbi shumën e papaguar të kredisë.

3.2 Përllogaritja dhe data për shlyerjen e interesit

Interesi për tu shlyer sipas Paragrafit 3.1, që shtohet ditë pas dite, përllogaritet mbi bazën e numrit aktual të ditëve të kaluara për Periudhën respektive të Interesit dhe një viti prej 360 ditësh, dhe, përveçse siç parashikohet në Paragrafin 6.1, paguhet/shlyhet tre herë në vit e prapambetur nga ana e Huamarrësit për Huadhënësin në Datat e Shlyerjes së Interesit.

3.3 Kamatëvonesa

Në rast të mosrealizimit nga ana e Huamarrësit të shlyerjes në datën e caktuar të çdo shume përkatëse sipas marrëveshjes aktuale, Huamarrësi paguan interes mbi shuma të tilla duke filluar nga data e një mosrealizimi të tillë deri në datën aktuale të shlyerjes sipas normës të specifikuar në Shtojcën 3. Interesi i mosrealizimit për sa i përket Paragrafit 3.3 shlyhet në Datat e Shlyerjes së Interesit.

4. TARIFAT DHE SHPENZIMET

4.1 Tarifa e angazhimit

Për periudhën që fillon në Datën e Përfundimit dhe që mbaron në fund të Periudhës së Disponueshmërisë, Huamarrësi do t'i paguaj Huadhënësit një tarifë angazhimi në normën e specifikuar në Shtojcën 3. Tarifa e angazhimit për t'u paguar sipas paragrafit aktual 4.1 përllogaritet nga Huadhënësi mbi bazën e numrit aktual të ditëve që kanë kaluar dhe një viti prej 360 ditësh mbi bilancin e tërhequr të Ofrimit të Kredisë në fillimin e çdo tre mujori kalendarik dhe paguhet e prapambetur nga ana e Huamarrësit për Huadhënësin në Datat e Shlyerjes së Interesit. Shlyerja e parë e tarifës së angazhimit sipas marrëveshjes aktuale realizohet në Datën e parë të Shlyerjes së Interesit që vjen menjëherë mbas Datës së Përfundimit.

4.2 Tarifa e administrimit

Huamarrësi, brenda 30 ditëve kalendarike mbas Datës së Përfundimit (por jo më vonë se 5 Ditë Pune para lëvrimit të parë të Ofrimit të Kredisë), i paguan Huadhënësit tarifën e administrimit të specifikuar në Shtojcën 3.

4.3 Shpenzimet

i) Huamarrësi më tej i paguan Huadhënësit me kërkesë të tij shpenzimet e dokumentuara dhe të arsyeshme (përfshirë shpenzimet ligjore, të përkthimit dhe udhëtimit dhe shpenzimet që lidhen me dorëzanësin/garantuesin e OeKB) të realizuara prej tij/Huadhënësit gjatë padive për ose rikthimin e çdo shume për tj'u paguar sipas marrëveshjes aktuale.

ii) Të gjitha taksat, detyrimet, shpenzimet apo tarifat e caktuara për Huadhënësin nga Ministria e Financave e Shqipërisë që lidhen me Marrëveshjen aktuale dhe operimet e përcaktuara prej saj i përkasin llogarisë së Huamarrësit dhe janë të pagueshme prej tij për Huadhënësin.

4.4 Primi/ shperblimi i dorëzanësit

Sipas Marrëveshjes aktuale Huadhënësi krediton Huamarrësin për një kompensim lidhur me primin e OeKB në mënyrën e mëposhtme:

i) Primi i Dorëzanësit dhe tarifa e administrimit të OKB të pagueshme paraprakisht

Huamarrësi brenda 30 ditëve kalendarike mbas Datës Përfundimtare (por jo më vonë se 5 Ditë Pune para lëvrimit të parë të Ofrimit të Kredisë) i paguan Huadhënësit një pjesë paraprake për kompensimin e primit të dorëzanësit të OeKB dhe tarifën e administrimit të përcaktuara në Shtojcën 3 në shumat e specifikuara në të njëjtin paragraf.

ii) Primi i Dorëzanësit të OeKB i Pagueshëm si Kufi

Duke filluar me Datën e Shlyerjes së Interesit e cila bie mbas Datës së Përfundimit, Huamarrësi i paguan Huadhënësit kompensimin për primin e dorëzanësit të OeKB të pagueshëm si kufi siç përcaktohet në Shtojcën 3. Kufiri i primit të dorëzanësit të OeKB paguhet çdo tre muaj në Datat e Shlyerjes së Interesit.

Programi i shlyerjes së shumave të pagueshme sipas Paragrafit 4.4 do të përcaktohet në garancinë përfundimtare të lëshuar nga OeKB. Huadhënësi informon Huamarrësin mbi lëshimin e garancisë dhe programin përkatës të shlyerjes dhe një njoftim i tillë bëhet pjesë përbërëse e Marrëveshjes aktuale.

Nëse gjatë afatit të Marrëveshjes së Eksportimit të Kredisë, primi i garancisë së OeKB rritet për shkak se (i) ka ndryshuar vlerësimi i riskut tregtar të realizuar nga OeKB për sa i përket lëshimit të garancisë së saj ose (ii) është rënë dakord mbi ndryshimet materiale në afatet kontraktuale të Marrëveshjes

së Eksportit të Kredisë, Huamarrësi riimburson Huadhënësin në bazë të kërkesës për një rritje të tillë.

5. SHLYERJA

5.1 Shlyerja e detyrueshme

Huaja e papaguar në fund të Periudhës së Disponueshmërisë paguhet nga ana e Huamarrësit me këste shlyerje të barabartë gjashtë mujorë në Datat e Detyrueshme të Shlyerjes të përcaktuara në Shtojcën 3. Huadhënësi, brenda 15 ditëve kalendarike mbas Datës së Përkohshme të Pranimit njofton Huamarrësin mbi listën e Datave të Detyrueshme të Shlyerjes dhe shumat për t'u paguar në datat përkatëse.

5.2 Shlyerja opsionale e parakohshme

Huamarrësi mund të parapaguaj tërësisht ose një pjesë (nëse pjesërisht, në shumën e përcaktuar në Shtojcën 3 ose shumëfishime përbërëse të saj/shumës) të Huasë duke njoftuar Huadhënësin paraprakisht me shkrim të paktën tridhjetë (30) ditë kalendarike (një njoftim i tillë mbetet i pakthyeshëm) mbi datën e propozuar të parapagimit në varësi të aprovimit nga ana e OeKB dhe në varësi të shlyerjeve të çdo kostoje të ndarë të shkaktuar prej Huadhënësit. Çdo parapagim i tillë, nëse realizohet gjatë Periudhës së Disponueshmërisë, redukton shumën e Ofertës së Kredisë me një shumë të barabartë parapagimin në fjalë. Çdo referim i Ofertës së Kredisë në Marrëveshjen aktuale që nga ai moment gjykohet si referim ndaj shumës së përcaktuar në Shtojcën 3 të reduktuar në këtë mënyrë. Çdo parapagim i tillë, nëse realizohet mbas përfundimit të Periudhës së Disponueshmërisë, aplikohet për të reduktuar me shuma të barabarta këstet e mëvonshme për t'u paguar të shlyerjes.

6. PAGESAT

6.1 Njoftimi i pagesës

Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para secilës Datë të Pagesës së Interesit ose, sipas rastit, Datës së Detyrueshme të Pagesës, Huadhënësi njofton Huamarrësin mbi shumat për t'u paguar nga ky i fundit në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes aktuale për sa i përket principalit, interesit dhe tarifës së administrimit, me kusht që mos njoftimi i mësipërm të mos çliroj Huamarrësin nga detyrimi i tij për të realizuar pagesat e shumave në fjalë në afatin e duhur.

Njoftimi gjithashtu specifikon, për çdo pagese që realizohet në bazë të Marrëveshjes aktuale, shumën e saktë dhe qëllimin e pagesës (përvetësimin mbi shumat për t'u paguar nga Huadhënësi) dhe Huamarrësi realizon pagesën në mënyrën e njoftuar dhe konfirmon aplikimin e fondeve me shkrim. Huamarrësi njofton Huadhënësin me shkrim mbi qëllimin e pagesës (përvetësimin e fondeve) për çdo shumë të paguar Huadhënësit. Në rastet e marrjes së një informacioni të tillë, aplikohet Paragrafi 6.6.

Në rastet kur çfarëdolloj shume i debitohet apo kreditohet Ofertës së Kredisë dhe/ose çdo llogarie tjetër e cila mund të hapet lidhur me Marrëveshjen aktuale në çdo moment brenda pesëmbëdhjetë ditëve kalendarike para çdo Date të Pagesës së Interesit, interesi apo çdo shumë tjetër për t'u paguar për sa i përket sa më sipër në një Datë të tillë të Pagesës së Interesit mbartet dhe bëhet e pagueshme ndaj Huadhënësit në Datën pasardhëse të Pagesës së Interesit, respektivisht (në rastin e shumave të kredituara) do të përllogaritet në Datën pasardhëse të Pagesës së Interesit.

6.2 Metoda e pagesës

Në secilën Datë të Pagesës së Interesit, Datë Pagese apo ditë tjetër përkatëse për pagese të çdo shume për t'u paguar sipas Marrëveshjes aktuale, sipas rastit, Huamarrësi do të realizoj pagesën e shumave dhe monedhës për t'u paguar në një datë të tillë sipas Marrëveshjes aktuale në Vjenë, vlera e datës përkatëse të pagesës.

Të gjitha pagesat nga ana e Huamarrësit kundrejt Huadhënësit për shumat për t'u shlyer sipas Marrëveshjes aktuale realizohen të këmbyeshme dhe të transferueshme në Euro në Vjenë.

6.3 Heqja dorë nga zëvendësimi apo kundërkërkesa

Huamarrësi në këtë mënyrë heq dorë pjesërisht apo plotësisht nga zëvendësimi apo kundërkërkesa që mund të ketë përsa i përket çdo shume të pagueshme kundrejt Huadhënësit të Marrëveshjes aktuale dhe bie dakord se nuk do të ndaloj pagesa për çfarëdolloj arsye të shumave për t'u paguar. Në veçanti, Huamarrësi nuk do të ndaloj pagesa të shumave për t'u shlyer ndaj Huadhënësit sipas Marrëveshjes aktuale për arsye të pretendimeve, të drejtave për të vepruar, të drejtave dhe kërkesave kundër Eksportuesit të Projektit apo furnizuesve të tjerë për sa i përket Projektit.

6.4 Pagesat e lira nga mbajtja e taksave apo detyrimeve të tjera

Të gjitha pagesat e realizuara nga ana e Huamarrësit në bazë të Marrëveshjes aktuale realizohen pa zëvendësim apo kundërkërkesë dhe të lira, neto dhe të pa reduktuara përsa i përket çdo takse, detyrimi, reduktimi, ndalimi apo nga çfarëdolloj tarife tjetër aktuale apo në të ardhmen të Republikës së Shqipërisë

përveçse kur Huamarrësit i kërkohet me ligj të bëj zbritje/reduktime të tilla. Nëse një gjë e tillë kërkohet me ligj, shuma për t'u paguar nga ana e Huamarrësit për sa i përket shlyerjes në fjalë rritet deri në nivelin e nevojshëm për të siguruar, që mbas zbritjes së taksave, detyrimeve, reduktimeve, ndalimeve apo detyrimeve të tjera, Huadhënësi të marrë në datën përkatëse të shlyerjes në fjalë një shumë neto të barabartë me shumën që do të merrte në rast se nuk do të kërkohej të bëhej zbritja e taksave, detyrimeve, reduktimeve, ndalimeve apo detyrimeve të tjera në fjalë. Huamarrësi menjëherë i dorëzon Huadhënësit çdo faturë, vërtetim apo provë tjetër që vërteton shumat (nëse ekzistojnë) e paguara apo për t'u paguar ne lidhje me zbritje apo ndalime si më sipër.

6.5 Kostot e rritura

Nëse për shkak të :

- ndonjë ndryshimi apo aplikimi të një ligji, rregulloreje apo kërkese rregullatore ose ndryshimi në interpretimin apo zbatimin e Marrëveshjes aktuale

- pajtimit nga ana e Huadhënësit me ndonjë drejtim, kërkesë apo nevojë (me fuqi ligjore apo jo) të ndonjë banke qendrore, monetare, rregullatore apo autoriteti tjetër

(përfshirë, në secilin rast, pa kufizim, çështje që lidhen me mjaftueshmërinë e kapitalit, likuiditetin, asetet rezervë dhe depozitat e veçanta) kërkohet

a) të rritet kostoja e apo vendosja e një kostoje shtesë mbi Huadhënësin për realizimin apo ruajtjen e angazhimit të tij të mundshëm ose për ruajtjen apo financimin e huasë; dhe/ose

b) të reduktohet shuma për t'u paguar apo kthimi real ndaj Huadhënësit sipas Marrëveshjes aktuale; dhe/ose

c) të zvogëlohet norma e kthimit të Huadhënësit mbi kapitalin e tij të përgjithshëm për shkak të një ndryshimi në mënyrën në të cilën i kërkohet/Huadhënësit të alokojë burime kapitale ndaj detyrimeve të tij në bazë të Marrëveshjes aktuale; dhe/ose

d) t'i kërkojë Huadhënësit të realizojë një shlyerje ose paraprijë një kompensimi të përllogaritur duke ju referuar atij kundrejt çdo shume të përfituar apo të përfitueshme sipas Marrëveshjes aktuale,

atëherë, Huamarrësi i paguan Huadhënësit në bazë të kërkesës çdo kosto, reduktim, pagesë apo kompensim paraprirës.

Çdo vërtetim i Huadhënësit lidhur me çdo kosto, reduktim, pagesë apo kompensim paraprirës të tillë, në mungesë të një gabimi të dukshëm, mbetet tregues përfundimtar dhe detyrues për Huamarrësin.

Për qëllim të klauzolës në fjalë, Huadhënësi, me mirëkuptim, mund të alokojë apo shpërndaj kostot dhe/ose humbjet përgjatë aseteve dhe detyrimeve të tij (apo në çdo nivel të tyre) siç kërkohet.

6.6 Përvetësimi i pagesave

Të gjitha pagesat e përfituara nga Huadhënësi prej Huamarrësit sipas Marrëveshjes aktuale (përveçse kur Huadhënësi ndryshon rendin e aplikimit) do të zbatohen nga ana e Huadhënësit ndaj pagesës së shumave për t'u paguar sipas Marrëveshjes aktuale sipas rendit të mëposhtëm dhe Huamarrësi në këtë mënyrë miraton zbatimin e shlyerjeve të tilla sipas rendit në fjalë (dhe ndaj çdo ndryshimi të tij nga ana e Huadhënësit):

a) shuma për t'u paguar sipas paragrafit 4.2 (Shpenzimet dhe tarifa e administrimit);

b) shuma për t'u paguar sipas paragrafit 4.3 (Primi i garancisë së OeKB);

c) shuma për t'u paguar sipas paragrafit 4.1 (Tarifa e angazhimit);

d) shuma për t'u paguar sipas paragrafit 3.3 (Interesi i kamatëvonesës);

e) shuma të cilave u ka kaluar afati sipas paragrafit 3.1 (Interesi);

f) shuma të cilave u ka kaluar afati sipas paragrafit 5.1 (Shlyerja e detyruar);

g) shuma për t'u paguar sipas paragrafit 3.1 (Interesi);

h) shuma për t'u paguar sipas paragrafit 5.1 (Shlyerja e detyrueshme);

i) shuma për t'u paguar sipas paragrafit 5.2 (Parapagimi jo i detyrueshëm).

Huadhënësi do të njoftoj Huamarrësin mbi çdo aplikim të fondeve. Shumave të cilave u ka kaluar afati shlyhen para shumave për t'u paguar. Çdo udhëzim i kundërt nga ana e Huamarrësit nuk do të merret parasysh.

Huamarrësi në këtë mënyrë pranon se sipas garancisë, OeKB ka rezervuar ndaj Huadhënësit të drejtën për të ndryshuar përvetësimin e pagesave siç përcaktohet më sipër. Në një rast të tillë, Huadhënësi njofton menjëherë Huamarrësin me shkrim dhe Huamarrësi pranon përvetësimin e OeKB dhe në këtë mënyrë ndërmerr të shlyej Huanë dhe çdo shumë tjetër të papaguar sipas Marrëveshjes aktuale sipas njoftimit (përfshirë një përllogaritje të detajuar) të Huadhënësit për Huamarrësin.

7. KUSHTET PARAPRAKE

Ofrimi i Kredisë aktuale do të vihet në dispozicion të Huamarrësit në datën ("Datën e Mbylljes") kur Huamarrësi njoftohet nga ana e Huadhënësit se kushtet e mëposhtme janë plotësuar në formë dhe përmbajtje:

i) Huadhënësi të ketë marrë:

a) një kopje të Marrëveshjes së Blerjes të pranueshme në formë dhe të pranueshme për Huadhënësin së bashku me një vërtetim nga Eksportuesi i Projektit në një datë jo më shumë se katërmbëdhjetë ditë para Datës së Mbylljes me qëllim që Marrëveshja e Blerjes në formën e paraqitur Huadhënësit të ketë fuqi dhe efekt të plotë (Shtojca 6);

b) një opinion të Ministrit të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë e pranueshme për Huadhënësin me një përmbajtje siç mund të kërkohet prej tij/Huadhënësit (sipas Shtojcës 5), së bashku me kopje të vërtetuara të çdo miratimi apo autorizimi të përmendur në një mendim të tillë;

c) një kopje të vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë e cila aprovon në parim Marrëveshjen aktuale;

d) Përfaqësues ligjor lëshuar nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë që autorizon një person apo persona të veçantë për të nënshkruar Marrëveshjen aktuale dhe nënshkruar të gjithë dokumentacionin dhe njoftimet e tjera dhe/ose të dërguara që lidhen me Marrëveshjen aktuale;

e) Një origjinal të Marrëveshjes aktuale të nënshkruar siç duhet nga ana e personit apo personat e autorizuar nga përfaqësuesi ligjor të referuar në paragrafin (d) më sipër;

f) Mostra të vërtetuara të nënshkrimeve të personit apo personave të autorizuar për të nënshkruar të gjithë dokumentacionin dhe njoftimet e tjera të cilat i paraqiten Huadhënësit sipas Marrëveshjes aktuale në emër të Huamarrësit;

g) Një emërim të një personi kontakti/agjenti për Huamarrësin në Republikën e Austrisë për Marrëveshjen (Shtojca 7);

h) Çdo dokumentacion, të dhënë apo autorizim tjetër që mund të kërkohet nga Huadhënësi me qëllim realizimin e ligjshmërisë, vlefshmërisë, zbatueshmërisë dhe detyrueshmërisë së Marrëveshjes aktuale dhe operimeve të parashikuara prej saj.

ii) Huadhënësi duhet të jetë pajisur me:

a) garancinë e lëshuar nga OeKB për dhe në emër të Republikës së Austrisë në përputhje me Ligjin e Promovimit të Eksportit të vitit 1981, të përmirësuar, kushtet dhe afatet e të cilit të mund të plotësohen nga ana e Huadhënësit;

b) një marrëveshje ri-financimi me OeKB për Huanë;

c) një marrëveshje anësore me Eksportuesin e Projektit dhe një miratim nga ana e autoriteteve të Huadhënësit për Marrëveshjen në fjalë.

iii) çdo kusht shtesë (nëse ekziston) të kërkuar në garancinë e Republikës së Austrisë të lëshuar nga OeKB.

Mbas përmbushjes të të gjithave kushteve të lartpërmendura, Huadhënësi njofton menjëherë Huamarrësin sa më sipër. Në rast se kushtet në fjalë nuk do të jenë plotësuar brenda Periudhës së Përfundimit të specifikuar në Shtojcën 3 të Marrëveshjes aktuale, Marrëveshja në fjalë, pa cenuar detyrimin e Huamarrësit sipas Paragrafit 4.2, pushon se qeni detyruese mbi palët nënshkruese.

Secili nga dokumentet dhe njoftimet e lartpërmendura hartohet në gjuhën Angleze ose Gjermane. Në rast se nuk hartohen në gjuhën Angleze ose Gjermane, një përkthim i vërtetuar në Anglisht i bashkëngjitet dokumentit në fjalë.

8. RASTET E MOSPLOTESIMIT TE DETYRIMEVE

8.1 Rastet e mosplotësimit të detyrimeve

Secila nga rastet e mëposhtme përbën Mosplotësim të Detyrimeve

a) Mosshlyerja për më shumë se katërmbëdhjetë (14) ditë kalendarike të pagesës nga ana e Huamarrësit të çdo principali, interesi apo shume tjetër për t'u paguar për sa i përket Huasë; ose

b) Huamarrësi nuk arrin të realizoj siç duhet apo zbatoj ndonjë afat apo sipërmarrje që përfshihet në Marrëveshjen aktuale përveçse pagesën e principalit, interesit apo shuma të tjera për një periudhë prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike më përpara se data në të cilën Huamarrësi informohet/bëhet i vetëdijshëm për mosrealizimin dhe data në të cilën njoftimi me shkrim për një mosrealizim të tillë ku i kërkohet Huamarrësit të realizoj angazhimet t'i jetë paraqitur Huamarrësit nga ana e Huadhënësit; ose

c) Çdo garanci apo sipërmarrje e Huamarrësit për sa i përket Marrëveshjes aktuale rezulton të ketë

qenë e pavërtetë në çdo aspekt material kur është realizuar; ose

d) Huamarrësi nuk ka plotësuar shlyerjen apo realizimin e ndonjë detyrimi për sa i përket fondeve të marra hua përveçse Huasë (përfshirë në çdo rast një detyrim sipas garancisë);

e) Lejet, miratimet, regjistrimet apo aprovimet (qeveritare apo ndryshe) të kërkuar për vlefshmërinë, zbatueshmërinë apo ligjshmërinë e Marrëveshjes aktuale ose Huasë apo realizimin e saj janë tërhequr apo ndërprerë nga fuqia dhe efekti i plotë për çfarëdolloj arsye; ose

f) Republika e Shqipërisë deklaron një moratorium të përgjithshëm ndaj kreditorëve për detyrimet e saj shlyerse; ose

g) Çdo rast i cili në gjykimin e arsyeshëm të Huadhënësit përbën një ndikim material të kundërt ndaj aftësisë së Huamarrësit për të plotësuar detyrimet e tij sipas Marrëveshjes aktuale; ose

h) Garancia e Republikës së Austrisë lëshuar nga OeKB apo ndonjë prej dispozitave të saj anulohet, i jepet fund apo pushon së pasuri fuqi dhe efekt të plotë ose pushon së siguruari sigurinë e menduar apo bëhet e paligjshme ose shpallet e pavlefshme për arsye apo rrethanë që i atribuohet/përket sferës/palës së Huamarrësit.

8.2 Të vepruarit ndaj rasteve të mosplotësimit të detyrimeve

Në rast se Mosplotësimi i Detyrimit ka ndodhur dhe vazhdon mbas atij momenti, atëherë secili apo të gjithë veprimet e mëposhtme mund të ndërmerren nga ana e Huadhënësit:

a) Huadhënësi mund, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Huamarrësit, të deklaroj menjëherë për t'u paguar principali dhe interesi i grumbulluar për sa i përket Huasë dhe të gjitha shumat e tjera për t'u paguar sipas Marrëveshjes aktuale, pas së cilës sa më sipër konsiderohen për t'u paguar pa deklarim, kërkesë, kundërshtim apo njoftim tjetër të çdo lloji;

b) Huadhënësi mund, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Huamarrësit, të deklaroj Ofrimin e Kredisë të përfunduar, pas së cilës detyrimi i Huadhënësit për të realizuar dhe vazhduar Huanë sipas Marrëveshjes aktuale përfundon menjëherë; dhe

c) Çdo veprim tjetër të cilin Huadhënësi vendos të ndërmarrë sipas gjykimit të tij realist.

Huamarrësi në këtë mënyrë bie dakord të paguaj Huadhënësin sipas kërkesës për të gjitha humbjet, shpenzimet e arsyeshme dhe detyrimet të cilat Huadhënësi mund t'i shkaktohen si rrethanë e ndonjë mosplotësimi të detyrimeve (përfshirë por që nuk kufizohet vetëm me interesat e paguar nga Huadhënësi kreditorëve të fondeve të marra hua për të ruajtur çdo shumë të pashlyer). Një vërtetim nga ana e një nëpunësi të Huadhënësit të autorizuar sipas rregullave i cili përcakton shumën e humbjeve të tilla, shpenzimet e arsyeshme dhe detyrimet si dhe bazën e përllogaritjeve të tyre në momentin e paraqitjes pranë Huamarrësit, mbeten (përveçse kur është fjala për gabim të qartë) provë përfundimtare mbi shumën e humbjeve, shpenzimet e arsyeshme dhe detyrimet në fjalë me kusht që një vërtetim i tillë të mbështetet në dokumentacion që provon sa më sipër.

Huamarrësi, në momentin që bëhet me dije, njofton me shkrim Huadhënësin mbi:

a) çdo rast të Mosplotësimit të Detyrimeve; ose

b) çdo rrethanë, rast apo veprim i cili me dhënien e njoftimit apo me kalimin e kohës apo të dyja së bashku ose plotësimin e ndonjë rrethane mund të çoj në apo përbëj Mosplotësim të Detyrimeve.

9. GARANCITE/AUTORIZIMET DHE ANGAZHIMET

9.1 Garancitë/autorizimet

Me qëllim nxitjen e Huadhënësit për të realizuar Marrëveshjen aktuale dhe për të favorizuar dhe ruajtur Huanë e siguruar prej saj/Marrëveshjes, Huamarrësi realizon në Datën e Pranimit garancitë e mëposhtme:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë autorizohet të veproj në emër të dhe për Republikën e Shqipërisë dhe të detyroj ligjërisht Republikën e Shqipërisë. Për rrjedhojë, detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes aktuale mbeten detyrime të pakufizuara dhe të padiskutuara të Republikës së Shqipërisë. Ndaj Republika e Shqipërisë mund të ngrihet padi në emër të saj për sa i përket detyrimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes aktuale.

b) Huamarrësi nuk është mbrapa me ndonjë nga detyrimet e tij shlyerse dhe se asnjë Rast Mosplotësimi i Detyrimeve nuk ka ndodhur apo është duke ndodhur, ose

c) Huamarrësi ka fuqi të realizoj Marrëveshjen aktuale dhe të marrë hua sipas saj/Marrëveshjes dhe të zbatoj, përmbush dhe realizoj Marrëveshjen aktuale dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për autorizimin/sanksionimin e kushteve dhe afateve të Marrëveshjes aktuale dhe sanksionimin e zbatimit, përmbushjes dhe realizimit të saj e cila përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues për Huamarrësin

të zbatueshëm në përputhje me afatet e saj; ose

d) Zbatimi, përmbushja dhe realizimi i Marrëveshjes aktuale nuk do të shkel ndonjë dispozitë të ligjit ekzistues apo rregulloreve të zbatueshme ndaj tij/Huamarrësit ose ndaj çdo marrëveshje, kontrate apo sipërmarrje tjetër në të cilën Huamarrësi është palë apo e cila është detyruese mbi Huamarrësin apo asetet e tij; ose

e) Janë nxjerrë apo realizuar me fuqi dhe efekt të plotë të gjitha lejet, miratimet, regjistrimet apo aprovimet (qeveritare apo ndryshe) të nevojshme për sa i përket zbatimit, përmbushjes, realizimit, vlefshmërisë apo zbatueshmërisë të Marrëveshjes aktuale.

Garancitë/autorizimet e përcaktuara më sipër ekzistojnë edhe mbas zbatimit të Marrëveshjes aktuale dhe gjykohen të përsëriten në çdo Datë të Huamarrjes dhe Datë të Shlyerjes së Interesit.

9.2 Angazhimet

Huamarrësi në këtë mënyrë pranon dhe angazhohet me dhe ndaj Huadhënësit si më poshtë:

a) Arkiva/të dhënat

Huamarrësi bën të mundur:

1. që (i) Blerësi i projektit të mbaj të dhëna të përshtatshme për të identifikuar pajisjet dhe shërbimet e financuara me anë të Huasë, (ii) Blerësi i Projektit bën të njohur përdorimin e të dhënave në Projekt dhe (iii) Blerësi i projektit regjistron ecurinë e projektit përfshirë edhe koston e tij;

2. Përfaqësuesit e Huadhënësit të lejohen të inspektojnë Projektin, sipërmarrjen e Blerësit të Projektit, pajisjet dhe shërbimet të siguruara sipas Marrëveshjes së Blerjes dhe çdo të dhënë dhe dokumentacion përkatës;

3. Të pajiset ose t'i siguroj Huadhënësit të gjithë të dhënat në fjalë sipas kërkesës së Huadhënësit lidhur me shpenzimet e Huasë, Projektin dhe pajisjet dhe shërbimet e siguruara sipas Marrëveshjes së Blerjes.

b) Pari Passu dhe garancitë negative

Detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes aktuale klasifikohen të paktën pari passu dhe të barabarta me të gjitha detyrimet e tjera të papaguara, të pasiguruara dhe të pavarura të tij. Nga Data e Pranimit për sa kohë që ndonjë pjesë e Huasë mbetet e papaguar, Huamarrësi nuk vendos apo bie dakord të vendosë pjesërisht apo plotësisht ndonjë hipotekë, detyrim, garanci, garanci pagese apo interes tjetër sigurie mbi asetet e tij për të siguruar ndonjë detyrim apo siguruar garancinë e ndonjë detyrimi përveçse kur Huaja sigurohet në mënyrë të barabartë sipas pranimit të Huadhënësit.

c) Përmirësimi i Marrëveshjes së Blerjes

Huamarrësi nuk realizon, lejon, bie dakord për ndonjë përmirësim, ndryshim, modifikim apo përfundim të Marrëveshjes së Blerjes pa aprovimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

10. LIGJI MBIZOTERUES DHE MOSMARRVESHJET

a) Marrëveshja aktuale bazohet/drejtohet nga ligji i Republikës së Austrisë.

b) Të gjitha mosmarrëveshjet lidhur me Marrëveshjen aktuale, përfshirë dhënien fund, vlefshmërinë dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve të mëposhtme zgjidhen përfundimisht sipas Parimeve të Arbitrazhit dhe Pajtimit që ekzistojnë në atë moment të Dhomës së Tregtisë në Paris me anë të tre arbitrave.

c) Vendi i Arbitrazhit është Parisi. Gjuha që do të përdoret në seancat e arbitrazhit është gjuha Angleze.

d) Vendimi i arbitrazhit vendos mbi detyrimet e palëve për sa i përket shpenzimeve të shkaktuara prej tyre.

e) Arbitrat bëjnë të gjitha përpjekjet për të drejtuar seancat dhe përgatitur vendimin e tyre në një mënyrë të tillë që ai/vendimi të jetë i zbatueshëm në ligj.

f) Vleresimi/apelimi mbi vendimin mund të paraqitet në çdo gjykatë e cila zotëron juridiksionin ose apelimi mund të bëhet në gjykata të tilla për një pranim gjyqësor të vendimit dhe një urdhër zbatimi, sipas rastit.

g) Në rast se Huadhënësi ndërmerr veprime ligjore (përfshi padi, arbitrazh, ndalim, zbatim apo çdo masë tjetër zbatuese apo ndaluese) ndaj Huamarrësit për sa i përket çdo çështje që lind nga Marrëveshja aktuale, Huamarrësi në këtë mënyrë heq dorë nga e drejta e imunitetit të cilën mund ta zotëroj.

h) Huamarrësi emëron Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Vjenë si personi i kontaktit (Shtojca 7).

11. TE PERGJITHSHME

11.1 Njoftime

Të gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimet e tjera janë të efektshme në rast të njoftimit me shkrim me anë të letrës së regjistruar kur merren ose, në rastin e njoftimit me faks, kur merren nga pala së cilës i kërkohet apo lejohet të paraqesë ose realizojë njoftime, kërkesa dhe komunikime të tjera të tilla sipas Marrëveshjes aktuale, t'i adresohen Huamarrësit apo Huadhënësit respektivisht në adresat e përcaktuara në Shtojcën 1, ose në çdo adrese tjetër të përcaktuar njeri-tjetrit me shkrim në të ardhmen në përputhje me Paragrafin 11.1.

11.2 Titujt përshkrues

Titujt në Marrëveshjen aktuale jepen vetëm për lehtësi referimi dhe nuk përcaktojnë ose kufizojnë dispozitat e saj.

11.3 Heqja dorë, zgjidhjet e përbashkëta

Asnjë mosrealizim apo vonesë nga ana e Huadhënësit në ushtrimin e çdo të drejte, privilegji apo autoriteti sipas Marrëveshjes aktuale dhe asnjë drejtim i marrëdhënieve ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit nuk funksionon si heqje dorë prej Marrëveshjes; as që ushtrimi i pjesshëm apo i vetëm e ndonjë të drejte, autoriteti apo privilegji sipas Marrëveshjes aktuale nuk cenon ushtrime të tjera apo të mëtejshme të saj ose ushtrimin e çdo të drejte, autoriteti apo privilegji tjetër. Të drejtat dhe zgjidhjet e siguruara qartë në këtë Marrëveshje mbeten të përbashkëta dhe jo përjashtuese të ndonjë të drejte apo zgjidhje të cilën Huadhënësi do ta zotëronte në të kundërtën. Asnjë njoftim për apo kërkesë ndaj Huamarrësit në çdo rast nuk i jep atij të drejtën ndaj ndonjë njoftimi apo kërkese tjetër ose të mëtejshme për sa i përket rrethanave të njëjta ose nuk përbëjnë heqje dorë nga e drejta e Huadhënësit nga veprime të tjera apo të mëtejshme lidhur me rrethanat në fjalë pa njoftuar apo paraqitur kërkesë.

11.4 Pavlefshmëria e pjesshme

Nëse ndonjë nga dispozitat e Marrëveshjes aktuale gjykohet nga çdo gjykatë apo gjykatë tjetër kompetente si e pazbatueshme, atëherë vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të saj në asnjë mënyrë nuk ndikohen apo dëmtohen për sa më sipër dhe palët përkatëse do të përdorin përpjekjet e tyre më të mëdha për të rishikuar dispozitën e pavlefshme në mënyrë që ta bëjnë atë të zbatueshme në përputhje me qëllimin e shprehur të Marrëveshjes aktuale.

11.5 Transferimi

Huamarrësi nuk mund të ngarkoje apo transferojë plotësisht apo pjesërisht të drejtat dhe detyrimet e tij sipas Marrëveshjes aktuale pa pëlqimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

Huadhënësi mund t'i transferojë të drejtat dhe detyrimet e tij sipas Marrëveshjes aktuale (i) pa pëlqimin e Huamarrësit, në rast se përfituesi është OeKB (vetëm në rastin e Mosplotësimit të Detyrimit) ose çdo bankë tjetër apo institucion financiar, dhe (ii) me pëlqimin paraprak me shkrim të Huamarrësit e cila nuk duhet t'i refuzohet në mënyrë të paarsyeshme ndaj çdo përfituesi tjetër.

11.6 Konfidencialiteti

Huamarrësi në këtë mënyrë bie dakord që Huadhënësit t'i jepet e drejta të paraqes në një mënyrë, të zakonshme për bankat, të gjitha të dhënat, që merr për sa i përket Marrëveshjes aktuale ose marrëdhënieve të saj tregtare me Huamarrësin- veçanërisht në interes të një mbrojtje të arsyeshme të kreditorëve- bankave, institucioneve të përbashkëta të bankave ose organizatave të preferuara për mbrojtjen e kreditorëve.

Huamarrësi në këtë mënyrë më tej bie dakord që Huadhënësit t'i jepet e drejta të jap të dhëna që rezultojnë nga Marrëveshja aktuale ose marrëdhënies tregtare të tij/Huadhënësit me Huamarrësin për personat apo kompanitë e mëposhtme:

a) çdo anëtari të grupit të kompanive të Huamarrësit,

b) një transferuesi apo përfituesi të mundshëm ose çdo personi apo kompani e cila mund të propozoje hyrjen në marrëdhënie kontraktuale me Huadhënësin për sa i përket Marrëveshjes aktuale,

c) OeKB dhe Republikës së Austrisë, dhe

d) Çdo personi, autoriteti apo entiteti tjetër ndaj të cilit Huadhënësit i kërkohet të bëj të njohur çdo të dhënë të tillë në zbatim të një ligji apo vendimi të çdo gjykate ose organizmave të tjerë rregullator me udhëzimet e të cilëve Huadhënësit i duhet të pajtohet.

11.7 Ndryshime të Marrëveshjes

Marrëveshja aktuale nuk mund te modifikohet apo ndryshohet përveçse me anë të instrumenteve me shkrim.

12.HYRJA NE FUQI

Marrëveshja aktuale hyn në fuqi pasi nënshkruhet sipas rregullit nga palët e mëposhtme dhe të

ratifikohet nga ana e Parlamentit të Republikës së Shqipërisë dhe të botohet në buletinin zyrtar shqiptar, të titulluar “Fletorja Zyrtare”.

NË DËSHMI TË KËSAJ, palët e mëposhtme kanë nënshkruar Marrëveshjen aktuale në datën e shkruar më sipër në dy kopje origjinale në gjuhën Angleze dhe versioni i gjuhës Angleze mbetet detyrues dhe mbizotërues mbi çdo përkthim.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
Duke vepruar në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrës
(përfaqësuar nga Ministria e Financave)

UniCredit Bank Austria AG si Huadhënës

SHTOJCA I

PALET

HUAMARRESI

Emri: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
Duke vepruar në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrës
(përfaqësuar nga Ministria e Financave)

Adresa: Ministria e Financave
Bul. Dëshmorët e Kombit, Nr. 1
Tirana, Albania
Telefon: (355 4) 222 84 05
Faks: (355 4) 222 84 05

HUADHENESI

Emri: UniCredit Bank Austria AG
Adresa: Schottengasee 6-8, A-1010 Vienna
Telefon: +43(0)5 05 05-87332
Faks: +43(0)5 05 05-56934
Departamenti përgjegjës: 8243 Export Finance
Vëmendje: znj. Doris Pingnitter

SHTOJCA 2

1. Projekti

Përmirësimi i pajisjeve mjekësore për Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”
në Tiranë

2. Marrëveshja e Blerjes:

Marrëveshja datë 30 prill 2009 ndërmjet AME International GmbH ("Eksportuesi i Projektit") dhe Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Shqipërisë ("Blerësi i Projektit") për shumën prej 7,488,000 EURO (shtatë milion katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë Euro) lidhur me projektin.

SHTOJCA 3

1. Kredia e ofruar (Paragrafi 2.2)

Një shumë që nuk i kalon 7,488,000 EURO (shtatë milion katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë Euro).

2. Periudha e disponueshmërisë (Paragrafi 2.2)

Nga Data e Mbylljes (siç përcaktohet në Paragrafin 7) deri në ditën që përkon me 18 muaj mbas saj/Datës së Mbylljes.

3. Interesi (Paragrafi 3.1)

0 % në vit

4. Kamatëvonesa (Paragrafi 3.3)

3 muaj EURIBOR plus një marzh prej 2% p.a

5. Tarifa e Angazhimit (Paragrafi 4.1)

0.5 % p.v (zero pikë pesë përqind në vit)

6. Tarifa e Administrimit (Paragrafi 4.2)

0.5 (zero pikë pesë përqind) i pandryshuar ndaj Kredisë

7. Primi i Garancisë (Paragrafi 4.3)

i) Primi i Garancisë së OeKB paraprakisht i pagueshëm

40,041.24 EURO

Shuma përfundimtare do të përcaktohet nga OeKB mbas nxjerrjes së garancisë origjinale. Në rast se shuma përfundimtare ndryshon nga ajo e shpallura/treguara, Huamarrësi do të shlyej diferencën (nëse ekziston) brenda 30 ditëve kalendarike pasi të jetë njoftuar mbi ndryshimin nga ana e Huadhënësit.

ii) Primi i Garancisë së OeKB i pagueshëm si marzh.

1.059 për cent në vit

Sipas OeKB norma e mësipërme mbështetet nga një grant shtesë që arrin afërsisht 359,732,53 EURO nga Ministria Federale e Financave e Austrisë. Norma dhe granti përfundimtar, nëse ekziston, do të përcaktohet nga OeKB mbas nxjerrjes së garancisë origjinale.

8. Tarifa e Trajtimit e OeKB

1,440 EURO për sa i përket Sigurimit të Kredisë se Eksportit

9. Datat e Detyrueshme të Shlyerjes (Paragrafi 5.1)

Shlyerja do të realizohet deri në 17 këste të barabarta 6-mujore të njëpasnjëshme, i pari për t'u paguar 48 muaj mbas Datës Provizore të Pranimit, në çdo rast jo më vonë se 66 muaj mbas Datës së Mbylljes.

10. Shuma Opsionale e Parapagimit (Paragrafi 5.2)

500,000 Euro

11. Periudha e Përfundimit (Paragrafi 7)

Periudha që fillon në Datën e Pranimit deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike, të paktën, nga Data e Pranimit.

SHTOJCA 4

PROCEDURAT E PAGESES

Huamarrësi në këtë mënyrë autorizon në mënyrë të pakthyeshme Huadhënësin të paguaje Eksportuesin e Projektit deri në maksimumin e shumës së Kredisë të përmendur në Shtojcën 3 kundrejt paraqitjes së

.....[procedurat e detajuara do të shtohen}.....

Paradhënia:

15% (pesëmbëdhjete përlind) e shumës se Marrëveshjes se Blerjes e cila është 1,123,200 EUR.- (me fjale: një milion e njëqind e njëzet e tre mije e dyqind) janë te pagueshme si një paradhënie, pas paraqitjes te:

-Faturës se paradhënies te Eksportuesit te Projektit Project ne 3 (tre) origjinale dhe 3 (tre) kopje

-Kopje të Obligacionit te Performances te lëshuar nga një Banke Austriake ne shumën prej 5% te Marrëveshjes se Blerjes

-Kopje te Garancisë se Paradhënies te lëshuar nga një Banke Austriake ne shumën prej 15% te Marrëveshjes se Blerjes

Pagesa kundrejt dërgesës

80% (tetëdhjete përqind) te shumës se Marrëveshjes se Blerjes e cila është 5,990,400 EUR- (ne fjale: pese milion e nëntëqind e nëntëdhjete mije e katërqind) janë te pagueshme me paraqitjen e dokumenteve te mëposhtëm:

-Faturës Tregtare te Eksportit te Projektit ne 3 (tre) origjinale, te gjitha te firmosura siç duhet nga Eksportuesi i Projektit, dhe 3 (tre) kopje.

-Certifikatën e Sigurimit ne 1 (një) origjinal dhe 3 (tre) kopje.

-Listës se paketimeve ne 1 (një) origjinal dhe 3 (tre) kopje.

-Fatura e Transportit Ndërkombëtar (CMR) Kopje te Dërgesës, te vulosur dhe firmosur nga Transportuesi, te shënuar “Ngarkese e Parapaguar” Numrin e Kontratës qe tregon marrësin e ngarkesës ……....

dhe / ose

Setin e plote te Faturës Detare “E paster ne Bord” te Ngarkesës ose Fatura e Transportit te Kombinuar FIATA te ngarkesës ne 3 (tre) origjinale dhe tre (3) kopje te pakalueshme bere pa urdhër, e panënshkruar, qe njofton Blerësin e Projektit, duke treguar si port destinancioni ndonjë port detar ne Shqipëri, qe tregon numrin e kontratës

dhe / ose

Faturën e Transportit Ajror ne 1 (një) origjinal dhe 3 (tre) kopje, qe tregon si destinancion ndonjë

aeroport ne Shqipëri, qe tregon ngarkesën e parapaguar, numrin e kontratës qe tregon marrësin e ngarkesës ……secili duke deklaruar portin/ aeroportin e destinacionit ne Shqipëri, transportin e parapaguar, numrin e kontratës, marrësin e ngarkesës.

Pagesa kundrejt COHO

5% (pese përqind) e shumës se Kontratës se Blerjes e cila është 374,400 EUR.- (ne fjale: treqind e shtatëdhjetë e katër mije e katërqind) janë te pagueshme kundrejt paraqitjes se:

-Faturën tregtare te Eksportuesit te Projektit ne 3 (tre) origjinale dhe 3 (tre) kopje dhe

-tre (3) kopje te COHO-se përkatëse.

Huadhënësit i jepet e drejta të bazohet mbi çdo dokument të cilin e gjykojnë si të vërtetë dhe të saktë dhe që është i nënshkruar dhe dërguar nga personi i duhur. Huadhënësi nuk mban përgjegjësi apo detyrime për formën, mjaftueshmërinë, saktësinë, vërtetësinë, falsifikimin apo fuqinë ligjore të secilit dokument/e ose për kushtet e përgjithshme dhe/ose të veçanta të parashikuara në dokument/e apo të mbivendosura mbi to; as që merr detyrime dhe përgjegjësi për përshkrimin, sasinë, peshën, cilësinë, kushtet, paketimin, shpërndarjen, vlerën apo gjendjen e pajisjeve ose shërbimeve të përfaqësuara nga secili dokument/e, ose për besimin apo veprimet dhe/ose lënien jashtë, aftësinë e pagimit, realizimin apo qëndrimin e depozituesit, transportuesve, marrësve të ngarkesës, apo siguruesve të pajisjeve ose të çdo personi tjetër kushdo qoftë.

Janë te lejuara dërgesa te pjesshme dhe paraqitje te pjesshme te dokumenteve.

Huadhënësi do të pajis Huamarrësin me një njoftim me shkrim mbas realizimit të një Huamarrje drejt/për Eksportuesin e Projektit.

Pasi një Huamarrje të jetë realizuar për Eksportuesin e Projektit, Huadhënësi do t'i ridërgoj dokumentacionin përkatës Huamarrësit me anë të një shërbimi korrier të veçantë.

SHTOJCA 5

OPINIONI LIGJOR
(Mostër)

Nga: Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë

Drejtuar: UniCredit Bank Austria AG

Datë:.....

Unë, ..., duke vepruar me cilësinë e Ministrit të Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, i referohen marrëveshjes së eksportit të kredisë për një hua të butë Nr. 229.611 për shumën prej 7,488,000 EURO ("Marrëveshja") datë: ..... Maj 2009 dhe autorizoj Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë të veproj në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrës (përfaqësuar nga Ministri i Financave) ("Huamarrës") dhe UniCredit Bank Austria AG si huadhënës ("Huadhënës"). Shpreh mendimin tim për sa i përket ligjeve të çdo juridiksioni përveç atyre të Republikës së Shqipërisë.

Kam kontrolluar kopjen e nënshkruar dhe përfunduar të Marrëveshjes dhe dokumente të tjerë të gjykuar të nevojshëm dhe të përshtatshëm me qëllim që të mund të paraqes mendimin në fjalë. Afatet e përcaktuara në Marrëveshje mbartin të njëjtin kuptim përveçse kur Marrëveshja e përcakton ndryshe.

Bazuar në sa më sipër, kam mendimin se:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë autorizohet të veproj në emër të dhe për Republikën e Shqipërisë dhe të detyroj ligjërisht Republikën e Shqipërisë. Për pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes aktuale janë të pakufizuara dhe të padiskutuara detyrime të Republikës së Shqipërisë. Ndaj Republika së Shqipërisë mund të ngrihet padi në emrin e saj për sa i përket detyrimeve të Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshje.

b) Ministria e Financave autorizohet të veproj në emër të Huamarrësit dhe të detyroj ligjërisht Huamarrësin. Për pasojë, të gjitha detyrimet sipas Marrëveshjes aktuale janë të vlefshme dhe ligjërisht detyruese dhe detyrime për t'u zbatuar nga Huamarrësi. Huamarrësi gëzon cilësinë të ngrej padi apo t'i ngrihet padi në emrin etj.

c) Huamarrësi gëzon autoritetin të hy/nënshkruaj dhe realizoj Marrëveshjen. Huamarrësi ka marrë të gjitha masat e nevojshme (qeveritare dhe ndryshe) për të autorizuar nënshkrimin e Marrëveshjes sipas

afateve dhe kushteve që ajo parashikon dhe ekzekutimin, dorëzimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes.

d) Marrëveshja është nënshkruar nga Z. ..... me cilësinë e Ministrit të Financave të Republikës së Shqipërisë.

e) Marrëveshja e nënshkruar nga Ministri i Financave në emër të Huamarrësit përmban detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin të zbatueshme në gjykatat e Republikës së Shqipërisë në përputhje me afatet e saj.

f) Personi ose personat që nënshkruajnë Marrëveshjen, që nënshkruajnë apo vërtetojnë çdo dokument tjetër lidhur me Marrëveshjen zotërojnë fuqi dhe autoritet të plotë për të vepruar në këtë mënyrë në emër të Huamarrësit.

g) Ekzekutimi dhe realizimi i Marrëveshjes dhe operimet e parashikuara prej saj nuk cenojnë (i) ligjet, rregulloret ose urdhrat zyrtar apo gjyqësor; (ii) traktatet, marrëveshjet ose dokumente apo instrumente të tjerë në të cilët Huamarrësi dhe/ose Republika e Shqipërisë është palë ose që ka efekt detyrues mbi të apo mbi asetet respektive të saj.

h) Të gjithë autorizimet, aprovimet (përfshirë, nëse është e nevojshme, aprovimet e shkëmbimeve të kontrollit), pëlqimet, lejet, përjashtimet, të dhënat, regjistrimet, noterizimet dhe kërkesat e tjera të autoriteteve dhe institucioneve qeveritare, gjyqësore, dhe publike të nevojshme ose të rekomandueshme lidhur me ekzekutimin, zbatimin, vlefshmërinë dhe realizimin e Marrëveshjes apo çdo pagese të realizuar sipas saj, janë nxjerrë dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë dhe Huamarrësi gëzon autoritetin e plotë për të realizuar të gjitha shlyerjet sipas Marrëveshjes në Euro.

i) Të gjitha shumat për t'u paguar nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes mund të realizohen të plota dhe pa zbritje për ose përsa i përket çdo tarife, takse, zbritje apo detyrim nga ana e Republikës së Shqipërisë, çdo autoritet politik apo tatimor. Në rast të ndonjë ndalimi/zbritje për sa i përket shlyerjeve të interesit sipas Marrëveshjes, detyrimi i Huamarrësit për të shlyer shuma shtesë sipas Paragrafit 6.4 mbetet i vlefshëm dhe i zbatueshëm.

j) Marrëveshja aktuale është ratifikuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe botuar në buletinin zyrtar Shqiptar të titulluar "Fletore Zyrtare" dhe nuk është e nevojshme apo këshillueshme që të sigurohet ligjshmëria, vlefshmëria, zbatueshmëria apo pranueshmëria si dëshmi të Marrëveshjes në mënyrë që ajo të arkivohet apo regjistrohet pranë ndonjë autoriteti tjetër qeveritar apo agjenci në Republikën e Shqipërisë.

k) Përzgjedhja e Ligjit të Republikës së Austrisë për të drejtuar Marrëveshjen mbetet një zgjidhje e vlefshme ligjore dhe njihet dhe zbatohet në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë.

Huamarrësi i nënshtrohet ligjit civil për sa i përket detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes aktuale. Lidhja dhe realizimi i Marrëveshjes nga ana e Huamarrësit përbën akte private dhe tregtare. Heqja dorë nga imuniteti në Paragrafin 10. (g) të Marrëveshjes mbetet e vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin.

l) Nuk është e nevojshme sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë (i) me qëllim mundësimin e Huamarrësit për të zbatuar të drejtat e tij sipas Marrëveshjes, ose (ii) për shkak të ekzekutimit, realizimit dhe zbatimit të Marrëveshjes, që Huamarrësi të licencohet, kualifikohet apo t'i jepet e drejta për të realizuar marrëdhënie tregtare në Republikën e Shqipërisë.

Huadhënësi as është as do të jetë rezident, me banim të përhershëm, të realizoj marrëdhënie tregtare apo t'i nënshtrohet tatimit në Republikën e Shqipërisë për shkak të vetëm të ekzekutimit, realizimit dhe zbatimit të Marrëveshjes.

m) Dispozitat e Paragrafit 10 të Marrëveshjes mbeten të ligjshme, vlefshme dhe detyrues sipas Legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Gjykatat e Republikës së Shqipërisë do të njohin çdo vendim dhe/ose gjykim arbitrazhi lidhur me Marrëveshjen si të vlefshëm dhe përfundimtar dhe do të zbatojnë vendime gjyqësore dhe/ose gjykime të tilla arbitrazhi.

Një vendim i emërtuar në EUR (Euro) do të njihet dhe zbatohet në Republikën e Shqipërisë.

Me sa dihet, nuk ekziston asnjë çështje gjyqësore, arbitrazhi apo çështje administrative aktuale apo e mbetur pezull ndaj Huamarrësit e cila do të or mund të rezultonte në një ndryshim të kundërt material në kushtet financiare apo të përbashkëta të Huamarrësit.

n) Marrëveshja dhe i gjithë dokumentacioni tjetër nuk përmban ndonjë dispozitë e cila duhet të ruhet e pazbatueshme sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

o) Detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes në çdo rast do të renditen pari passu me të gjitha detyrimet e tjera të Huamarrësit përveç detyrimeve të parashikuara si të detyrueshme nga ligji.

Ky mendim ligjor paraqitet për përfitimin e vetëm të Huadhënësit dhe mund të mos i bëhet i njohur një personi tjetër.

SHTOJCA 6

KONFIRMIMI SE MARREVESHJA E BLERJES MBETET NE FUQI DHE ME EFEKT TE PLOTE

{Huamarrësi}

Ref: Marrëveshjes së eksportimit të kredisë për një hua të butë Nr. 229.611 për shumën prej 7,488,000 EURO ("Marrëveshja") datë: ..... Maj 2009 dhe autorizoj Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë të veproj në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrës (përfaqësuar nga Ministri i Financave) ("Huamarrës") dhe UniCredit Bank Austria AG si huadhënës ("Huadhënës").

Të dashur zotërinj,

Në këtë mënyrë ju konfirmojmë se Marrëveshja e Blerjes {nr. ...} arritur më {.....} ndërmjet {.....} dhe {.....} ka hyrë në fuqi më {.....}.

Vjenë, ...

.....
{Eksportuesi i Projektit}

SHTOJCA 7

PRANIMI I EMERIMIT TE PERSONIT TE KONTAKTIT

{Huamarrësi}

Ref: Marrëveshjes së eksportimit të kredisë për një hua të butë Nr. 229.611 për shumën prej 7,488,000 EURO ("Marrëveshja") datë: ..... Maj 2009 dhe autorizoj Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë të veproj në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrës (përfaqësuar nga Ministri i Financave) ("Huamarrës") dhe UniCredit Bank Austria AG si huadhënës ("Huadhënës").

Të dashur Zotërinj,

Si Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Vjenë, Republika e Austrisë, pranoj, në emrin tim dhe në emër të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, emërimin si person të autorizuar të Huamarrësit për të shërbyer si person kontakti për Eksportimin e Kredisë.

Adresa ime në Vjenë: .....

Në rast të ndryshimit të adresës, do t'ju njoftoj me shkrim pa vonesë.

Sinqerisht

.....
Ambasada e
Republikës së Shqipërisë në Austri
Vendi, data .....